



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

M J E D I S I I
F A V O R S H Ë M
P Ë R
A K T I V I T E T I N
F I L A N T R O P I K

NË SHQIPËRI

© PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM. TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.

TIRANË, SHQIPËRI, MAJ 2022

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të WINGS dhe Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e WINGS dhe Bashkimit Evropian.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



W I N G S
ELEVATING PHILANTHROPY

PËRMBAJTJA

HYRJE

PËRKUFIZIMET MBI MJEDISIN E FAVORSHËM TË
AKTIVITETIT FILANTROPIK

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR I AKTIVITETIT
FILANTROPIK NË VENDET E BASHKIMIT EVROPIAN

- 8** Bullgaria
- 10** Kroacia
- 12** Rumania
- 13** Sllovenia
- 16** Franca
- 16** Italia
- 16** Hollanda

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR I AKTIVITETIT FILANTROPIK NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

- 17** Bosnja dhe Hercegovina
- 19** Kosova
- 23** Mali i Zi
- 23** Maqedonia e Veriut
- 23** Serbia

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PËR AKTIVITETIN FILANTROPIK NË SHQIPËRI

NJË KUADËR LIGJOR DHE RREGULLATOR I DËSHIRUESHËM MBI AKTIVITETIN FILANTROPIK

HYRJJE

Filantropia po rritet në nivel global, kryesisht për rolin e saj unik në mbështetjen e zhvillimeve të qëndrueshme sociale dhe ekonomike. Sjellja altruiste tregohet veçanërisht në kohë krizash (fatkeqësi natyrore, pandemia COVID-19, etj.). Pasja e një mjedisi ligjor e rregullator të favorshëm, dialogu konstruktiv dhe bashkëpunimi me institucionet shtetërore, përveçse ndikojnë në promovimin e kulturës dhe rritjen e vlerave filantropike, janë thelbësore edhe për zhvillimin e filantropisë në një vend. Gjithashtu, ekziston besimi se filantropia e zhvilluar institucionalisht mund të stimulojë investime strategjike dhe të ketë një ndikim të rëndësishëm në zgjidhjen e çështjeve ekonomike dhe sociale. Ndërsa shumë vende dhe kultura kanë tradita të hershme në fushën e filantropisë, sektori aktual i filantropisë së institucionalizuar po rritet në nivel global.

“Mjedisi i favorshëm për aktivitetin filantropik në Shqipëri” prezanton një analizë krahasimore të vendeve të Bashkimit Evropian, Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë mbi kuadrin ligjor dhe rregullator që rregullon fushat e veprimtarive të njohura ligjërisht për aktivitetin filantropik dhe lehtësirat dhe stimujt fiskalë për sektorin privat. Veprimtaritë dhe lehtësirat fiskale janë dy ndër sfidat që sektori privat në Shqipëri ndesh kur kryhen aktivitete dhurimi. Studimi nuk fokusohet tek lehtësirat tatimore për dhurimin individual, pasi kjo formë dhurimi nuk është e rregulluar nga pikapamja ligjore.

Ky dokument politikash është i organizuar në tre seksione: (i) kuadri ligjor i aktivitetit filantropik në vendet e Bashkimit Evropian, (ii) kuadri ligjor dhe rregullator mbi aktivitetin filantropik në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe (iii) kuadri ekzistues ligjor në Shqipëri, si dhe skenari që do të ishte më mundësues për vendin lidhur me aktivitetin filantropik.

Partnerët Shqipëri përgatiti dhe përdori një set mjetesh metodologjike, duke përfshirë hulumtim literature së bashku me përfaqsimin me pjesëmarrje në sigurimin e informacionit. Hulumtimi i literaturës u krye gjatë periudhës dhjetor 2021 – mars 2022. Ai përfshiu mbledhjen e të dhënave dhe informacionit bazuar në faqet zyrtare të institucioneve publike, si dhe në studime dhe të dhëna të kryera nga organizata dhe institucione ndërkombëtare. Gjetjet paraprake nga hulumtimi i literaturës u konsultuan gjatë tre takimeve të organizuar me përfaqësues të biznesit, dhomave të tregtisë dhe industrisë dhe bizneseve që kanë politika të përgjegjësive sociale.

PËRKUFIZIME MBI MJEDISIN E FAVORSHËM TË AKTIVITETIT FILANTROPIK

Filantropia luan një rol të rëndësishëm në mobilizimin e mbështetjes private për të mirën publike. Prandaj, ajo nuk përbën vetëm një praktikë komunitare, por edhe një mjet për hartimin, zhvillimin dhe mbështetjen e politikave nga autoritetet publike, mjet i cili ka qenë objekt i shumë diskutimeve kontroversale. Studimet kanë treguar se bazat institucionale të filantropisë ndryshojnë në varësi të regjimeve ligjore që rregullojnë sektorin jofitimprurës. Në të njëjtën kohë, në shumë vende është konstatuar një tendencë drejt rritjes së inkurajimit publik dhe fiskal mbi filantropinë. [1]

Por, cili është përkufizimi i një mjedisi të favorshëm/mundësues për filantropinë? Sipas Lilly Family School of Philanthropy “një mjedis filantropik mundësues ose i favorshëm ofron stimuj dhe kufizime të përshtatshme për të ndikuar pozitivisht në kapacitetin dhe prirjen e individëve dhe institucioneve për t’u përfshirë lirisht në aktivitete filantropike në një mënyrë të qëndrueshme dhe efektive. Ky mjedis mundësues është produkt i një sërë kushtesh të ndërlidhura që janë rezultat i zgjedhjeve të qëllimshme të politikave të bëra nga institucionet qeveritare dhe traditat, burimet dhe trashëgimia historike, kulturore dhe socio-politike e një vendi apo ekonomie”. [2]

Për Shoqatën Filantropike Evropiane “Philea”[3], një mjedis i favorshëm mbi aktivitetin filantropik konsiston në formësimin e një kuadri ligjor kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar duke krijuar një Treg Unik për Filantropinë. Në Evropë, ka 147,000 fondacione, të cilat kanë statusin e përfitimit publik, me një shpenzim vjetor të akumuluar rreth 60 miliardë Euro. Ekzistenca e një Tregu Unik për Filantropinë synon të zhbllokojë potencialin e filantropisë në rimëkëmbjen dhe të ardhmen e Evropës, duke mobilizuar burime private për të mirën publike dhe lehtësimin e dhurimit ndërkufitar për veprimtaritë filantropike. Për rrjetin global WINGS, krijimi i një mjedisi mundësues kërkon kushte që:

(i) krijojnë procese të lehta për ekzistencën dhe funksionimin e institucioneve dhe sjelljeve filantropike,

(ii) mundësojnë rritjen, dhe

(iii) forcojnë dhe nxisin aktivitetin filantropik dhe ndikimin e tij në mënyrë që ky sektor të lulëzojë.

[1] Lambelet, 2014, “La Philanthropie” [Online] <https://www.cairn.info/la-philanthropie--9782724615456.htm>

[2] [2] Lilly Family School of Philanthropy, 2022 “Indeksi Global i Mjedisit Filantropik 2022” [Online] <https://globalindices.iupui.edu/environment-index/index.html>

[3] Informacioni është marrë nga faqa e internetit të Philanthropy European Association “Philea” [Online] <https://philea.eu/philanthropy-in-europe/enabling-environment/enabling-environment/>



**RREGULLIMI I
AKTIVITETIT
FILANTROPIK
NË VENDET E
BASHKIMIT
EVROPIAN**

Ky seksion fokusohet në veprimtaritë e aktivitetit filantropik të njohura për përfitimet tatimore dhe lehtësirat tatimore për kompanitë në vendet e Bashkimit Evropian.

BULLGARIA

Kuadri ligjor Bullgar parashikon një seri aktivitesh të pranueshme për të përfituar lehtësira tatimore. Sipas nenit 31, të Ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave[4], për qëllime tatimore, shpenzimet për dhurimet njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën 10% të fitimit para tatimit, kur dhurimet bëhen për:

1. Objekte e pajisje shëndetësore dhe mjekësore;
2. Shërbime sociale, ose të integruara shëndetësore dhe sociale, për përkujdesje rezidenciale, sipas Ligjit për Shërbimet Sociale, si dhe Agjencisë për Ndihmë Sociale dhe "Mbrojtje Sociale" të Ministrisë të Punës dhe Politikës Sociale;
3. Çerdhe, kopshte, shkolla, universitete dhe institucionet akademike;
4. Ndërmarrjet buxhetore në kuptim të Ligjit të Kontabilitetit;
5. Komunitetet fetare të regjistruara;
6. Ndërmarrjet e specializuara ose kooperativat e personave me aftësi të kufizuara, të regjistruara në regjistrin sipas nenit. 83 të Ligjit për Personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe në favor të Agjencisë për Persona me Aftësi të Kufizuara;
7. Personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe ndihma teknike për ta;
8. Personat të lënduar në fatkeqësi në kuptim të Ligjit për Mbrojtjen nga

- Fatkeqësitë, dhe familjet e tyre;
9. Kryqin e Kuq Bullgar;
10. Persona të cilët pësojnë aksidente gjatë fatkeqësive natyrore dhe familjet e tyre;
11. Fëmijët me aftësi të kufizuara ose pa prindër;
12. Institutet kulturore ose për shkëmbimin kulturor, arsimor ose shkencor sipas traktateve ndërkombëtare ku Republika e Bullgarisë është palë;
13. Personat juridikë me qëllim jofitimprurës me status të përfitimit publik, përveç organizatave që mbështesin kulturën në kuptim të Ligjit për Patronazhit;
14. Financimin e efikasitë të energjisë dhe burimeve të rinovueshme;
15. Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara (UNICEF);
16. Ndërmarrjet sociale të regjistruara në regjistrin e ndërmarrjeve sociale, për të arritur qëllimet e tyre sociale dhe/ose kryer veprimtaritë e tyre sociale.

Për qëllime tatimore, shpenzimet për dhurimet njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën 50% të fitimit, kur dhurimi bëhet në favor të Fondit Kombëtar të Sigurimeve Shëndetësore, për veprimtaritë që lidhen me trajtimin e fëmijëve.

Për qëllime tatimore, asistencë e ofruar falas sipas Ligjit të Patronazhit njihet si shpenzim i zbritshëm deri në 15% të fitimit para tatimit. Për qëllime tatimore, kostoja e dhurimeve për kompjuterat dhe pajisjeve teknologjike, të kryera për shkollat publike, përfshirë edhe universitetet, njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 65% të fitimit para tatimit.

[4] Informacioni është marrë nga faqja e internetit e Balance BG [Online] <https://balans.bg/>

KROACIA

Sipas ligjit kroat “Për tatimin mbi të ardhurat e korporatave”[5], dhurimi mund të jetë në natyrë ose në mjete financiare. Veprimtaritë e pranueshme për lehtësira fiskale janë ato me natyrë kulturore, arsimore, mjekësore, humanitare, sportive, fetare, ekologjike, dhe qëllime të tjera për përfitim publik të dhëna ndaj shoqatave dhe personave të tjerë që ushtrojnë aktivitete në për të mirën publike. Zbritja tatimore për kompanitë është deri në 2% të të ardhurave të tyre vjetore bruto, por kjo përqindje mund të jetë edhe më e lartë në bazë të vendimit të ministrisë kompetente për financimin e programeve dhe veprimeve të veçanta. Dhurimet e ushqimit për personat e sëmurë për qëllime sociale, humanitare dhe qëllime të tjera, si dhe për njerëzit e prekur nga fatkeqësitë natyrore, të bëra nga taksapaguesit që janë prodhues dhe tregtarë ushqimesh mund të konsiderohen gjithashtu të zbritshme nga taksat.[6]

RUMANIA

Regjimi tatimor në Rumani parashikon lehtësira tatimore të ndryshme për veprimtari të ndryshme. Subjektet private gëzojnë një reduktim të bazës së tyre të tatueshme jo më shumë se:

(i) 10% të bazës së tatueshme në fushat e kulturës, artit, arsimit, shëndetësisë, ndihmës dhe shërbimeve sociale, veprimtarive humanitare, mbrojtjes së mjedisit;

(ii) 8% e bazës së tatueshme për sponsorizimin në fushat e arsimit, të drejtave të njeriut, shkencës dhe hulumtimit e kërkimit, filantropisë, mirëmbajtjes, ruajtjes dhe rritjes së vlerës së monumenteve historike, sporteve me përjashtim të futbollit.

(iii) 5% të bazës së tatueshme për sponsorizimin për aktivitetet sociale, komunitare, fetare, në përfaqësim të interesave të shoqatave profesionale në futboll.[7]

SLLOVENIA

Rregullimi i dhurimit në Slloveni varet nga natyra dhe struktura e biznesit që kryen një kompani. Sipas nenit 55, të ligjit “Tatimit mbi të ardhurat e korporatave”[8], bizneset mund:

(i) të kërkojnë një ulje të bazës tatimore në masën 100% të shumës që përfaqëson investimet në kërkim dhe zhvillim. Investimet nga ky nen përfshijnë investime në:

1. Aktivitetet e brendshme të kërkimit dhe zhvillimit të biznesit, duke përfshirë blerjen e pajisjeve të kërkimit dhe zhvillimit që përdoren ekskluzivisht dhe në mënyrë të përhershme në zbatimin e aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit të biznesit;
2. Blerjen e shërbimeve të kërkimit dhe zhvillimit (të kryera nga ofrues të tjerë, duke përfshirë biznese të tjera, ose organizata të tjera kërkimore publike ose private). Me rastin e përcaktimit të shumës me të cilën tatimpaguesi mund të ulë bazën tatimore sipas këtij paragrafi, merren parasysh shumat për investime sipas këtij paragrafi, sipas dispozitave të këtij ligji për përcaktimin e bazës tatimore. Investimet në kërkim dhe

[5] Informacioni është marrë nga faqja e internetit e bazës së të dhënave të ligjit [Online] <https://www.zakon.hr/z/99/Zakon-o-porezu-na-dobit>

[6] Informacioni është marrë nga faqja e internetit të PWC Worldwide [Online] <https://taxsummaries.pwc.com/croatia/corporate/deductions>

[7] Philea, 2021, “Mjedisi Ligjor për Filantropinë në Evropë 2020, Profili i Shtetit të Rumanisë” [Online] https://philea.eu/wp-content/uploads/2021/12/Romania_2020LegalEnvironmentPhilanthropy.pdf

[8] <http://pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=ZAKO4687>

zhvillim sipas këtij paragrafi duhet të përcaktohen nga tatimpaguesi në një plan biznesi ose në një projekt apo program të veçantë zhvillimi.

(ii) një zbritje prej 40% të investuar në pajisje të caktuara dhe pasuri të paluajtshme;[9]
 (iii) Tatimpaguesi mund të kërkojë një ulje të bazës tatimore në masën 40% të shumës që përfaqëson investimet në transformimin dixhital dhe tranzicionin e gjelbër në këtë periudhë, por jo më shumë se shuma e bazës tatimore. Investimet nga ky paragraf janë investime në:

1. Informatikë, inteligjencë artificiale dhe të dhëna të mëdha;
2. Teknologjitë miqësore me mjedisin, transporti publik dhe privat më i pastër, më i lirë dhe më i shëndetshëm, dekarbonizimi i sektorit të energjisë, efikasiteti energjetik i ndërtesave dhe futja e standardeve të tjera për neutralitetin klimatik.

FRANCA

Në Francë, sektori privat mund të përfitojë nga një ulje e taksave e barabartë me 60% të dhurimeve për fondacionet e shërbimeve publike dhe për fonde dhuruese deri në 10,000 EUR ose deri në 0.5% të xhiros së tyre vjetore nëse kjo shumë është më e lartë se 10,000 €. Nëse nuk ka fitime në vitet në vijim, zbritja mund të bartet gjatë pesë viteve të ardhshme. Zbritja mund të bartet edhe gjatë 5 viteve në vijim, nëse dhurimet janë përtej kufirit 0.5%. Kompania themeluese mund të përfitojë gjithashtu nga një kredi tatimore në lidhje me dhurimin e bërë për një fondacion korporate që ajo ka krijuar. Nga 31 dhjetori 2020, Ligji Financiar 2020

vendos tavanin e dhuratës në 20,000 euro (ose ende 0.5% e xhiros vjetore).[10]

ITALIA

Italia përdor dy sisteme mbi dhurimet. Kompanitë mund të përfitojnë kreditim të taksave dhe zbritje të taksave. Në Itali, dhurimet e bëra për personat juridikë që ndjekin ekskluzivisht arsimin, rikrijimin, kujdesin social dhe shëndetësor, kërkimin shkencor mund të dhurojnë një shumë totale jo më të madhe se 2% e të ardhurave të deklaruara të korporatës. Gjithashtu, aplikohet një zbritje prej 30% nga tatimi mbi të ardhurat e parave të dhuruara në favor të popullatave të prekura nga fatkeqësi publike ose ngjarje të tjera të jashtëzakonshme, të bëra nëpërmjet fondacioneve, shoqatave, komiteteve dhe subjekteve të identifikuar në Dekretin e Kryeministrit të 20 qershorit 2000. Për më tepër, Kodi i Sektorit të Tretë parashikon një zbritje prej 10% të të ardhurave totale të deklaruara për para dhe donacione të bëra për të mbështetur subjektet jo-tregtare të Sektorit të Tretë.[11]

HOLLANDA

Tatimi mbi të ardhurat e korporatave holandeze ofron një mundësi për të zbritur dhurimet e kryera nga sektori privat. Dhurimet e kryera nga kompanitë janë të zbritshme deri në maksimum 50% të fitimit me një maksimum prej 100,000 EUR. Dhurimet për subjektet kulturore mund të merren parasysht për 150%. Megjithatë, zbritja maksimale shtesë është 2,500 EUR.[12]

[9] Informacioni është marrë nga faqja e internetit e Deloitte [Online] <https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/global/Documents/Tax/dtl-tax-sloveniahighlights-2020.pdf>

[10] Philea, 2021, "Mjedisi Ligjor për Filantropinë në Evropë 2020, Profili i Shtetit të Francës" [Online] https://philea.eu/wp-content/uploads/2021/12/France_2020LegalEnvironmentPhilanthropy.pdf

[11] Philea, 2021, Philea, 2021, "Mjedisi Ligjor për Filantropinë në Evropë 2020, Profili i Shtetit Itali" [Online] https://philea.eu/wp-content/uploads/2021/12/Italy_2020LegalEnvironmentPhilanthropy.pdf

[12] Philea, 2021, Philea, 2021, "Mjedisi Ligjor për Filantropinë në Evropë 2020, Profili i Shtetit të Hollandës" [Online] https://philea.eu/wp-content/uploads/2021/12/Netherlands_2020LegalEnvironmentPhilanthropy-1.pdf



**RREGULLIMI I
AKTIVITETIT
FILANTROPIK
NË VENDET E
BALLKANIT
PERËNDIMOR**

Ky seksion fokusohet në aktivitetet filantropike ligjore për mbështetje tatimore dhe lehtësirat tatimore për kompanitë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Sipas Ligjit[13] "Për tatimin mbi të ardhurat e korporatave", shpenzimet e kryera në dhurime për qëllime humanitare, kulturore, arsimore, shkencore dhe sportive, të cilat u jepen personave juridikë që nuk janë përgjegjës për tatimin mbi të ardhurat, ose personave fizikë që nuk kanë të ardhura të tjera njihen si shpenzime të zbritshme deri në 3% të të ardhurave totale në periudhën për të cilën është përcaktuar tatimi. Përveç kësaj, njihen si shpenzime të zbritshme deri në 3% në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës dhe deri në 2% në Republika Srpska për shpenzimet që mbështesin ngjarjet sociale ose projektet që nuk lidhen drejtpërdrejtë me aktivitetet e tyre të biznesit, me ose pa reciprocitet në reklama.

KOSOVA

Në Kosovë, dhurimet e kryera për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtjes së mjedisit dhe sportit, konsiderohen si kontribut i dhënë për interes publik dhe lejohen si zbritje deri në maksimum 10% të të ardhurave të tatueshme dhe llogaritet përpara tatimit të fitimit. Tatimpaguesit që kontribuojnë në sport kanë të drejtë të përfitojnë zbritje deri në 30% të

të tatimit mbi të ardhurat e korporatave; ndërkohë, ata që kontribuojnë për rininë dhe kulturën u jepet një zbritje deri në 20%.[14]

MALI I ZI

Në dhjetor 2021, Parlamenti i Malit të Zi miratoi një sërë ligjesh që janë pjesë e programit Evropa Tani[15]. Dhurimet e sektorit privat që kryhen për qëllime sociale, uljen e varfërisë, mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, kujdesin social për fëmijët dhe të rinjtë, kujdesin ndaj të moshuarve, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe pakicave, sundimi i ligjit, shoqëria civile dhe vullnetarizmi, integrimi euroatlantik dhe evropian i Malit të Zi, arti, kultura, promovimi i bujqësisë dhe zhvillimit rural, zhvillimi i qëndrueshëm, mbrojtja e konsumatorit, barazia gjinore, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe lufta kundër varësive, njihen deri në një prag prej 3.5% të të ardhurave totale.[16] Shpenzimet e bëra në këtë drejtim do të jenë të zbritshme për qëllime tatimore të korporatës, vetëm nëse ato u bëhen personave juridikë, të cilët janë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve të sipërpërmendura në përputhje me rregulloret specifike, dhe nëse fondet e marra përdoren nga këto subjekte ekskluzivisht për qëllimet e sipër përmendura.

[13] Informacioni është marrë nga faqja e internetit të kompanisë Paragraf [Online] <https://www.paragraf.ba/propisi/fbih/zakon-o-porezu-na-dobit.html>

[14] Informacioni është marrë nga faqja e internetit të PWC Worldwide [Online] <https://taxsummaries.pwc.com/kosovo/corporate/deductions>

[15] Informacioni është marrë nga faqja e internetit të firmës ligjore Karanovic & Partners [Online] <https://www.karanovicpartners.com/news/montenegro-assembly-passes-laws-from-programme-europe-now/>

[16] Informacioni është marrë nga faqja e internetit të PWC Worldwide [Online] <https://taxsummaries.pwc.com/montenegro/corporate/deductions>

MAQEDONIA E VERIUT

Sipas kornizës ligjore të Maqedonisë së Veriut, shpenzimet e dhurimeve janë të tatueshme nëse kryhen në përputhje me mënyrën, kushtet dhe procedurën e përcaktuar në Ligjin për dhurimet dhe sponsorizime në veprimtari publike dhe sportive. Nëse janë në përputhje me kërkesat e ligjit si më sipër, dhurimet për aktivitetet publike janë të tatueshme nëse shumat vjetore e përballuar nga kompania tejkalojnë 5% të të ardhurave të saj vjetore, ndërsa shpenzimet e sponsorizimit janë të tatueshme nëse tejkalojnë vlerën mbi 3% të të ardhurave të përgjithshme të kompanisë.

Në varësi të plotësimit të kushteve të caktuara, dhurimet për federatat kombëtare sportive, klubet sportive dhe sportistët aktivë, që kanë fituar një status të tillë në përputhje me kushtet e përcaktuara sipas Ligjit të Sporteve, mund të përfitojnë zbritje deri në 50% të vlerës mbi të ardhurat e korporatës.

SERBIA

Sipas Ligjit për tatimin mbi fitimin e korporatave, dhurimet e zbritshme lejohen për qëllime mjekësore, arsimore, shkencore, humanitare, fetare, të mbrojtjes së mjedisit dhe sportive, si dhe për donacione për institucionet e mbrojtjes sociale. OSHC-të nuk trajtohen ndryshe nga institucionet publike kur bëhet fjalë për fondet e dhuruara, atyre u njihen si shpenzime të zbritshme dhe parashikohen për zbritje tatimore deri në 5% të të ardhurave totale.

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PËR AKTIVITETIN FILANTROPIK NË SHQIPËRI

Kuadri ligjor dhe rregullator për aktivitetin filantropik në Shqipëri rregullohet me ligjin nr. 7892/1994 "Për Sponsorizimin", i ndryshuar, dhe Ligjin 8438/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ligji për Sponsorizimin rregullon mbështetjen e dhënë në ndihma financiare dhe materiale, të quajtur "sponsorizime" të veprimtarive sociale e publike ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe botuesve të shtypit. Neni 5 i Ligjit për Sponsorizimin^[17] njeh si shpenzim të zbritshëm deri në 5% për botuesit dhe botimet e literaturës, veprave shkencore dhe enciklopedisë; si dhe aktivitete kulturore, artistike dhe sportive dhe deri në 3% për të gjitha subjektet e tjera të korporatës. Për kompanitë që realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumat e sponsorizuara për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, të cilat janë brenda kufirit 5 % të fitimit para tatimit të parashikuar në ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", të ndryshuar, për efekt të përlllogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, këto sponsorizime janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar.

Për të përfituar nga ky lehtësim, kompania dhe marrësi i sponsorizimit duhet të ndjekin procedura të veçanta për marrjen e "Autorizimit të Sponsorizimit" nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Dokumentacioni që biznesi paraqet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për t'u pajisur me "Autorizimin e Sponsorizimit" është si më poshtë:

1. Për përfituesin e sponsorizimit paraqet se:
 - a) merr pjesë ose ka të drejtë të konkurrojë në nivel amator ose profesionist sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 79/2017 datë 27.04.2017 "Për sportin" dhe është pjesë e federatave sportive;
 - b) ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit në fuqi për sportet, prej të paktën 1 viti;
 - c) nuk ka detyrime tatimore të pashlyera;
 - ç) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e evazionit fiskal, mospagimit të detyrimeve tatimore apo falsifikimit të dokumenteve;
 - d) ka përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
 - dh) nuk është objekt i procedurave të falimentimit dhe/ose likuidimit apo ndonjë procedure tjetër të ngjashme;
 - e) nuk është pezulluar me vendim gjykate.
2. Për tatimpaguesin sponsorizues paraqet:
 - a) një deklaratë në të cilën angazhohet të japë sponsorizim për ekipin sportiv pjesë e federatës sportive që kërkon mbështetje financiare;
 - b) Kontratën e sponsorizimit midis sponsorizuesit dhe përfituesit;
 - c) dokumentacion bankar ku vërteton shumën e sponsorizimit të transferuar në llogarinë bankare të të sponsorizuarit;
 - d) në çdo rast, të njoftojë organet tatimore për shumat që transferon në vijim në kuadrin e "Autorizimit të sponsorizimit".

[17]https://jetimet.org/wp-content/uploads/2020/01/Ligji_7892_1994_Per_Sponsorizimet.pdf

3. Deklarime të tjera që shoqërojnë kërkesën e tatimpaguesit sponsorizues dhe të subjektit të sponsorizuar:

a) Sponsorizuesi dhe i sponsorizuari paraqesin një program mbi zhvillimin e sportit në të cilin parashikohen: nevojat për sponsorizim, përdorimi i fondeve të sponsorizimit gjatë vitit (duke evidentuar fondet që do të përdoren për zhvillimin, përmirësimin dhe rinovimin e infrastrukturës sportive evidentimin e talentëve dhe nevojat për trajnim, mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga organizimi i garave sportive), si dhe përfitimet që parashikohen të vijnë nga ky sponsorizim.

b) Deklaratën e të sponsorizuarit dhe sponsorizuesit, me anë të së cilës garantojnë vërtetësinë e të dhënave të dokumenteve dhe deklarimeve të paraqitura në aplikim;

c) Autorizimin me shkrim nga sponsorizuesi dhe i sponsorizuari, që pranojnë autoritetet tatimore për të kryer të gjitha verifikimet dhe kontrollet e nevojshme dhe në çdo kohë me qëllim garantimin e ligjit dhe të rregullave të përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe atë mbi sponsorizimet;

ç) Vetëdeklarim se sponsorizuesi dhe i sponsorizuari nuk janë në një situatë apo rrethanë të konfliktit të interesit.

d) Dokumentacioni dhe/ose vërtetimet e kërkuara më sipër paraqitet në format origjinal ose kopje të noterizuara të dokumentacionit të kërkuar.

Ligji për të ardhurat tatimore (neni 21, pika p, Ligji për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar 79/2019) përcakton gjithashtu se subjektet që kualifikohen për zbritje tatimore janë pasuri monetare dhe të paluajtshme deri në 5 për qind të fitimit para tatimit në rastet kur është shpallur situata emergjente "fatkeqësi natyrore". Në çdo rast, këto dhurime kualifikohen për zbritje vetëm

kur shumica e financimit derdhet në thesarin e shtetit.

Për sa i përket përvojës së sektorit privat dhe bazuar në hulumtimet e deritanishme[18], institucionet e telekomunikacionit dhe financiare janë sektorët më të përhapur që dhurojnë për arsye të ndryshme. Një arsye e veçantë është sepse këto entitete kanë strategji dhe struktura të vendosura në lidhje me përgjegjësinë sociale të korporatës (PSK).

Për sa i përket PSK-së, në vitin 2013, një sërë kompanish krijuan rrjetin e PSK. Rrjeti ishte i përbërë nga biznese dhe organizata të shoqërisë civile duke synuar promovimin e PSK-së në vend. Nevoja ishte edhe më e dukshme në Shqipëri, për faktin se nuk ekzistonte një rrjet i tillë dhe ku disa aspekte të PSK, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë, të drejtat e njeriut dhe standardet mjedisore, kishin nevojë për përmirësim.[19] Megjithatë, rrjeti nuk ka qenë shumë efektiv në krijimin e diskutimeve publike rreth rolit të PSK-së dhe mënyrave të mundshme për ta inkurajuar atë, si dhe në hartimin e programeve që do të zhvillonin strategjitë e PSK-së midis subjekteve private.[20]

Nga këndvështrimi i biznesit, kuadri ligjor dhe rregullator për dhurimet në Shqipëri nuk është shumë mundësues për këtë aktivitet. Aktivitetet e kryera në kuadër të përgjegjësisë sociale të korporatës dhe zhvillimit të komunitetit janë më të gjera se ato të parashikuara në ligjin për sponsorizimet. Kuadri rregullator pengon aktivitetin e tyre të përgjegjësisë sociale të korporatave, sepse edhe nëse një biznes dëshiron të investojë në projekte afatgjata me një sasi të konsiderueshme financimi,

[18] Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Partnerëve Shqipëri [Online] <http://partnersalbania.org/monthly-reports-monitoring-of-the-monitoring-of-philanthropic-activity-in-albania/>

[19] Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Antea Cement [Online] <https://www.anteacement.com/csr/albanian-csr-network/>

[20] <https://partnersalbania.org/publication/enabling-environment-for-philanthropic-activity-in-albania/>

ai nuk mund të kërkojë lehtësira tatimore përtej atyre të parashikuara në ligjin për sponsorizimin. Bazuar në zhvillimet e viteve të fundit, ka nevojë për përkufizime ligjore mbi terminologjitë lidhur me "dhurimet", "sponsorizimet", "filantropia", "crowdfunding", etj. Gjithashtu procedurat për të përfituar lehtësimin tatimor nuk duhet të jenë burokratike dhe të krijojnë vështirësi për kompanitë.

Gjatë diskutimeve me përfaqësues të biznesit rezulton se kompanitë përballen me tri sfida kryesore:

(i) Fashat 5% dhe 3% të lehtësirave tatimore janë të ulëta. Ato shërbejnë më shumë si qëllime "edukative" sesa si nxitës për kompanitë për të dhuruar.

(ii) Ligji për sponsorizimin duhet të ndryshohet, sepse nuk pasqyron ndryshimet dhe zhvillimet e viteve të fundit.

(iii) Aktivitetet e parashikuara për të përfituar nga lehtësirat tatimore janë të kufizuara. Ato duhet të përfshijnë më shumë fusha të interesit publik sesa ato të parashikuara në ligj.

Gjithashtu, në raste krize (pandemi, përmytje, etj.) kuadri ligjor duhet të ketë më shumë stimuj për dhurimet e korporatave për sektorin e prekur nga kriza (p.sh. sektori i shëndetësisë, etj.)

NJË RREGULLORE LIGJORE E DËSHIRUESHME MBI AKTIVITETIN FILANTROPIK

Ashtu siç u përshkrua më lart, ka nevojë për ndryshim dhe amendim të kuadrit ligjor mbi aktivitetin filantropik, për ta trajtuar këtë aktivitet, jo si një aktivitet bamirësie, por si një proces dhe ndërhyrje më strategjike me ndikim afatgjatë. Duke qenë se Ligji ekzistues Shqiptar për Sponsorizimin është miratuar në vitin 1994 dhe ndryshimi i fundit i tij ka ndodhur në vitin 2007, lind nevoja për ndryshimin e këtij ligji për të reflektuar nevojat socio-ekonomike dhe zhvillimin e vendit. Një skenar i dëshiruar për Shqipërinë do të ishte prezenca e një mjedisi mundësues, që përcakton një gamë të gjerë fushash dhe aktiviteteve, duke reflektuar zhvillimet e viteve të fundit. Bazuar në hulumtimin e kuadrit ligjor të vendeve të tjera në këtë punim, fusha të tilla si kërkimi dhe zhvillimet, sipërmarrjet sociale, të drejtat themelore të njeriut, shkenca e aplikuar dhe kërkimi, si dhe filantropia (si kuadri ligjor i Rumanisë), janë të rëndësishme të adresohen në rregulloret ligjore. Kuadri ligjor gjithashtu duhet të adresojë krijimin e një regjistri ose një sistemi për mbledhjen e të dhënave për veprimtarinë filantropike në vend. Për më tepër, duke qenë se ngritja e fondeve po bëhet një mjet i rëndësishëm që mbështet veprimet e komunitetit përmes platformave të drejtpërdrejta dhe online, është e rëndësishme të ekzistojë një kuadër ligjor dhe rregullator që adreson zhvillime të tilla.

Për sa i përket lehtësirave fiskale, skenari i dëshiruar do të ishte rritja në përqindje e këtyre lehtësirave për aktivitetet e pranueshme. Procedurat në lidhje me lehtësimin tatimor duhet të jenë të lehta dhe dhe të mos krijojnë barriera si për dhuruesin ashtu edhe për përfituesin e dhurimit.

Tre motive potenciale për ndërmarrjet për të kryer aktivitet filantropik janë:

- *më shumë stimuj fiskalë,*
- *partnerë të besueshëm për zbatimin e programeve filantropike, dhe*
- *më shumë informacion mbi programet në të cilat do të kontribuonin.*[21]

[21] <https://partnersalbania.org/publication/philanthropic-activity-of-enterprises-in-albania-second-survey-2016>

KONTAKT

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe
Zhvillim

Rruga e Elbasanit, Park Gate Building,
kati 10-të,
Ap. 71 / 73, Kutia Postare 2418/1,
1010 Tiranë, Shqipëri

www.partnersalbania.org
partners@partnersalbania.org